



# SPECIFIKIME TEKNIKE

Shërbimi i Pastrimit

Bashkia Korçë  
2026\_2029

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **OBJEKTI: SHËRBIMI I PASTRIMIT**

**(Pastrimi, evadimi i mbetjeve në Bashkinë e Korçës viti 2026-2029)**

#### **1.MBLEDHJA DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE URBANE**

##### **1.1.Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar numrin e konteniereve dhe koshave të vegjël, volumet dhe specifikimet e tyre për secilën pikë grumbullimi mbeturinash në zonën e kontratës.

Në qytet duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji për çdo ditë për: 400 konteniere në qytet (300 nga të cilat janë 1,7 m<sup>3</sup> dhe 100 janë 1,1m<sup>3</sup>) që do të zbrazen çdo ditë, 100 kazanë plastike për riciklim dhe 220 kosha të vegjël të cilat janë pronesi të bashkisë për hedhjen e mbeturinave me kapacitet 35 litra.

Në fshat do të kryhet shërbimi për 200 konteniere me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup>, të cilat do të vendosen sipas listës bashkëngjitur të fshatrave dhe 150 konteniere aktuale të cilat janë pronesi të bashkisë me kapacitet 120 litra që do të zbrazen 2 herë në javë. Fshatrat e mëdha, qëndër njësie dhe fshatrat turistike (Voskopoja dhe Dardha) do të kenë shërbim 3 herë në javë.

Gjithashtu sipërmarresi duhet të bëjë mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave në lagjet 1, 2, 3, 11 dhe 12, të cilat nuk kanë konteniere, me makina të vogla, konform specifikimeve teknike të makinave. Mbetjet e riciklueshme për lagjet 1, 2, 3, 4, 5, 11, 12 dhe 13 do të mbledhen 1 herë në javë (në qeset e shpërndara për këto qellime) deri me deri sikundër mbetjet e perdritshme.

Keto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së konteniereve për grumbullimin e mbetjeve sipas hartës bashkëngjitur.

Të gjithë kontenieret dhe kazanët plastikë për riciklim (gjithesëj 600 konteniere dhe 100 kazanë plastikë për riciklim) do të sigurohen nga operatori i shërbimit. Mirembajtja dhe siguria e tyre do të kryhet nga operatori i shërbimit.

##### **1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia.**

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në :

- a. Zbrazen e konteniereve me makinën e pershtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze 10 m nga çdo pikë grumbullimi, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m<sup>2</sup> rreth çdo pikë grumbullimi, si dhe rivendosja e konteniereve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenieret duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapake të mbyllur. Me pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

Gjithashtu do te kryhet cdo dite zbrazja e koshave te vegjel.

- b. Ne cmimin njesi te largimit te mbeturinave urbane perfshihet gjithashtu dhe dizifektimi ne perfundim me pluhur gelqereje me 5 % permbajtje klori, brenda cdo konteneri. Mund te behet dizifektimi ditor pas zbrazjes se cdo konteneri duke perdorur sistemin e dizifektimit qe duhet ta kete cdo makine teknologjike, duke perdorur te tretur lenden e pluhurit te gelqeres me 5 % permbajtje klori.

### **1.3 Plani i vendosjes se konteniereve dhe grafiket e punimeve**

1. Autoriteti kontratues ka percaktuar pikat ekzakte te grumbullimit te mbetjeve te ngurta urbane dhe numrit te konteniereve per secilen pike, ne te gjitha zonen e kontrates ku perfshihen edhe te gjitha pikat e grumbullimit prane te gjitha tregjeve brenda zones se kontrates.
2. Operatori i sherbimit eshte i detyruar te zbatoje planin fillestar te pikave te konteniereve te kerkuar (bashkengjitur specifikimeve teknike) si dhe cdo ndryshim te tyre pergjate kohes se zbatimit te kesaj kontrate. Ky plan mund te ndryshoje gjate kohes se zbatimit te kontrates me propozim te operatorit te sherbimit ose nga Autoriteti kontraktues sipas nevojave per permiresimin e sherbimit dhe mire organizimit te tij, ose si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukture gjithmone pas kerkeses se njeres pale dhe behen te zbatueshme pas miratimit te Autoritetit kontraktues.
3. Grafiket vjetor te punimeve per realizimin e sherbimit te pastrimit te zones, pergatiten nga operatori i sherbimit dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontraktues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte : 1. Oraret e operimit ne secilen pike kontenieresh 2. Llojin, targen dhe itenerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin 3. Oraret e operimit dhe mjetet per sherbimet mbeshtetese 4. Numrin e puntoreve qe do te mbeshtetin cdo operacion punimesh. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
4. Grafiket per largimin e mbeturinave qe do te paraqiten per miratim, duhet te pergatiten ne menyre te tille qe te gjitha punimet te kryhen brenda oreve te nates, duke filluar jo me pare se ora 20.00 me qellim qe ne oren 7.00 zona e kontraktuar te jete krejtesisht e paster. Per lagjet ku mbeturinat merren dere me dere dhe per fshatin ato do te largohen nga ora 7 deri ne oren 13.00
5. Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim vendet e grumbullimit te mbeturinave per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.
6. Vendet e grumbullimit te mbeturinave duhet te jene te pasterta gjate gjitha dites. Per kete sherbim operatori i sherbimit duhet te kete ne cdo ore te dites puntore per mirembajtjen e ketyre pikave.

### **1.4 Rregulla per t'u zbatuar**

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster piken e grumbullimit te mbeturinave ne perputhje me Rregulloren Nr. 1 dt. 05.02.2008 "Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit te qytetit" te miratuar me VKB Nr 7 Date 12.02.2008.
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen kazane te tejmbushur me mbeturina, te patransportuara dhe mbeturina te lena ne zonen perreth konteniereve. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit, i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te vendosen penalitete sipas parashikimit ne nenin "Gjoba dhe Penalitete".

- c. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane të prodhuara nga banorët, insitucionet dhe bizneset, që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të perseritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së konteniereve dhe përfshirjen e tyre në grafikun e punimeve.
- d. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontraktues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do të ketë me të treta, të reklamojë numrin e mjeteve dhe puntorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontraktues.
- e. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “Zyrë të Kontaktimit “Për marrjen e ankesave” e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00. Përfaqesues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktues dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.
- f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.
- g. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e puntorëve të transportit dhe shofereve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- h. Me Mbeturina të Ngurta Urbane nënkuptohen të gjitha mbetjet dhe materialet që për çdo rast përkruhen në nenin 4 të kreut I të rregullores nr. 1 datë 05.02.2008, “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit të qytetit”.
- i. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenieryt në rruget kryesore, mbasi se të jete kryer fshirja e tyre. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet të kryejë perseri zbrazjen e konteniereve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenieryt të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.
- j. Neqoftesë gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt, përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rena gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në kontratë apo me gjaba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- k. Përdorimi i uniformave për puntorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast moszbatimi aplikohen gjaba për mosplotësim të këtij detyrimi.

## 1.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të verë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontratale (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Kontenieryt për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave respektivisht si më poshtë:

- 300 kontenieryt metalikë 1,7m<sup>3</sup>
- 300 kontenieryt metalikë 1,1m<sup>3</sup>
- 100 kontenieryt plastikë me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup> për mbetje të riciklueshme.

Kontenieryt duhet të jenë në gjendje të rregullt, të lyer me të njëjten ngjyrë dhe të paisur me rrota, për lehtëzimin sa më të lehtë të tyre.

Kontenieryt do të vendosen sipas planit të vendosjes së përcaktuar e paraqitur kjo në hartën treguese.

Operatori i shërbimit mund të shtojë numrin e konteniereve kundrejt kërkesës zyrtare të Bashkisë në përputhje me kërkesat dhe vëllimet për gjatë kohëzgjatjes të kontratës.

Makina të nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë :

1. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor, anësor ose frontal për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10 ton, cope 6 (gjashtë), me dokumentacion të rregullt për qarkullim, si dhe 3 cope me kapacitet mbajtes jo më pak se 6 ton për transportin e mbeturinave të fshatit.
2. Makina kompatator për heqjen e mbeturinave në lagjet pa kontener, me kapacitet mbajtes jo më shumë se 4 ton, 2 (dy) cope, dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim si dhe 4 makina transporti të vogla me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1 ton për riciklim dhe menaxhim të menjëherëshëm.
3. Të gjitha makineritë teknologjike që do të përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikime teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.
4. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:
  - a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë, por jo më pak se njëherë në gjashtë muaj nga Autoriteti kontrator për gjendjen e gatishmerisë dhe inventarizimin e tyre.
  - b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjten ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të këmbimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmerisë së mjeteve.
  - c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dizifektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
  - d. Të gjithë konteneret e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen pastër, në gjendje të mirë teknike. Në rast demtimesh, djegiesh, deformimesh të konteniereve, si dhe demtime të rrotave ose kapakeve, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së konteniereve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e konteniereve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha demtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit, brenda 3 ditëve nga momenti i konstatimit të demtimit. Në rast të mosriparimit të plote të konteniereve, ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete sipas nenit “Penalitete dhe Gjoha”.
  - e. Operatori i shërbimit duhet të verë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave.
  - f. Detyrimisht në të gjitha makinat dhe konteneret duhet të shkruhet “Për një Korce me të pastër”, emri i firmës si dhe numri i telefonit të shërbimit 24 orësh të firmës.

## **2. LARJA DHE DIZIFEKTIMI I KONTENIEREVE**

### **2.1 Vëllimet e punimeve**

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dizifektojë 600 konteniere në muaj ose mesatarisht 15 konteniere në ditë, sipas grafikeve të miratuar nga Autoriteti kontratues.

## 2.1 Metodologjia

- a. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë konteneret çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plote dhe dizifektimin e tyre atje. Konteneret do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plote të tyre.
- b. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm konteneresh rezerve për të zëvendësuar çdo natë konteneret e larguar për t'u lare.
- c. Konteneret për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga Brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur forca dhe solucion lares.
- d. Me shërbim dizifektimi kuptojmë realizimin e shërbimit të dizifektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenerit.

## 2.2 Grafiket e punimeve

- a. Grafiket e punimeve për transportin, larjen dhe dizifektimin e kontenierëve, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues.
- b. Grafiket e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.
- c. Autoriteti kontrator ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipërpermendura, respektimin e standarteve të kerkuara, rregullave dhe çelësive të kerkuara nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

## 2.3 Rregulla për t'u zbatuar

- a. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj.
- b. Të gjitha lëndet dizifektuese dhe aromatike që përzihen me ujë për larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, pra përberja dhe leja e përdorimit të tyre miratohet me parë nga organet shtetërore shëndetsore dhe me pas nga Autoriteti kontratues. Mosmiratimi i lendeve kimike të përdorura për përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim dhe si rezultat nuk mund të kryhet pagesa.

## 2.4 Mjetet dhe pajisjet

- a. Kamjon me pedane për transportin e kazaneve që do të lahen me kapaciteti mbajtës deri 1 ton
- b. Lende dizifektuese dhe aromatizuese (dizifektues kimik) për dizifektimin e kontenierëve.
- c. Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozite uji si dhe mjete pune (pompe dhe pistoleta uji) për larjen me presion dhe dizifektimin e kontenierëve.
- d. Një sasi e konsiderueshme e pjeseve të këmbimit duhet të mbahet gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

## 3. HEQJA E MBETURINAVE INERTE PRANË VENDGRUMBULLIMEVE TË MBETURINAVE

Ky shërbim konsiston në:

- a. Mirembajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në zonën e kontratuar, si dhe mbetjeve voluminoze (ambalazhe) që tejmbushin artificialisht konteneret dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër konteniere.
- b. Ky shërbim kryhet me anë të kamioncinave vetshkarkuese dhe me fadrome.

- c. Grafiket vjetor te punimeve per realizimin e ketij sherbimi perгатiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte: 1. Oraret e operimit ne secilen pike kontenieresh 2. Llojin, targen dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin. 3. Oraret e operimit dhe mjetet per sherbimet mbeshtetese. 4. Numrin e puntoreve qe do te mbeshtesin cdo operacion punimesh.
- d. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit . Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- e. Grafiket qe do te paraqiten per miratim, duhet te perгатiten ne menyre te tille qe punimet te fillojne nga ora 10.00 deri 18.00, me qellim qe gjithe kesaj periudhe kohore kontenieret dhe vendet rreth tyre te jene krejtesisht te paster. Ndryshimet ne orarin e operimit dhe perfundimit ne zone do te pranohen vetem per shkak te pamundesise objektive te kryerjes se sherbimit te parashikuar, por gjithmone pasi te jene verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet ne Grafikun e punimeve.
- f. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe per kryerjen e sherbimeve te lartpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara , rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba per mospermbushjen e tyre.
- g. Per asnje rast nuk do te lejohen qe vendet e grumbullimit te mbeturinave te jene te papastruar nga mbetjet e mesiperme. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga ora e njoftimit apo konstatimit te problemit. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te vendosen sipas parashikimit te nenit “Penalitete dhe gjoba”.
- h. Operatori i sherbimit duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune, minimalisht numrin e kerkuar dhe te deklaruar te makinerive dhe pajisjeve dhe puntore per kryerjen me cilesi te ketij sherbimi.
- i. Ne qofte se gjate transportit derdhen papasteri nga makinat e sherbimit brenda ose jashte zones se sherbimit, ato duhet te pastrohen menjehere. Ne te kundert pervec shpenzimeve qe duhet te perballoje kontraktori per mbledhjen dhe largimin e mbeturinave te rena gjate transportit, ai do te perballat me penalitetet e parashikuara ne perputhje me kete kontrate apo me gjoba te tjera ne perputhje me ligjet dhe vendimet ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.
- j. Perdorimi i uniformave per puntoret qe kryejne sherbimin e pastrimit eshte rigorozisht i detyrueshem dhe ne rast moszbatimi aplikohen gjoba per mosplotesimin e ketij detyrimi.
- k. Me mbeturina ndertimore dhe te vellimshme nenkuptohen te gjitha llojet e mbeturinave te percaktuara ne nenin 4 te kreut 1 te rregullores “Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit te qytetit”.

### 3.2 Mjetet dhe pajisjet.

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per kryerjen e ketij sherbimi keto mjete dhe pajisje :

1. Fadrome me goma me kapacitet te koves jo më pak se 1 m<sup>3</sup>, 1 (nje) cope.
2. Kamion vetshkarkues per heqjen e inerteve me kapacitet mbajtes 1,5-3 ton, 2 (dy)cope.
3. Automjetet te cilat do te perdoren per kete sherbim mund te kontrollohen ne cdo kohe, por jo me pak se njehere ne gjashte muaj, nga Autoriteti kontrator per gjendjen e gatishmerise dhe inventarizimin e tyre.
4. Cdo makineri per kryerjen e ketij sherbimi duhet te pastrohet dhe lahet, ne fillim ose ne fund te itinerarit ditor.
5. Te gjitha makinat per transportin e mbeturinave ndertimore dhe te vellimshme duhet te jene te rregjistruara nga Autoriteti kontratues, te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire, si dhe te jene te lyera me te njeften ngjyre.

6. Nje liste e makinave per transportin e mbeturinave inerte dhe skeletike do t'i paraqitet Autoritetit kontratues para fillimit te veprimtarise se mesiperme.
7. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.
8. Emri dhe telefoni publik i operatorit te sherbimit dhe shkrimi "Per nje Korce me te paster" duhet te jene te dukshme ne automjetet e transportit te mbetjeve ndertimore dhe voluminoze, ku shkronjat duhet te jene te pakten 10 cm.

#### **4. SHERBIMI I PASTRIMIT NATEN. FSHIRJA E RRUGEVE DHE TROTUAREVE ME KRAHE.**

##### **4.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget, trotuaret dhe siperfaqet e tyre per te gjithë zonen e kontratuar.

Operatori i sherbimit do te fshije me krahe dhe do te kryeje te gjitha sherbimet e tjera mbeshtetese parashikuar ne metodologji per te gjitha rruget dhe trotuaret e percaktuara, ne zonen qe do te kontraktohet, ne nje siperfaqe te pergjitheshme prej 300 291 m<sup>2</sup> ne dite. Keto jane parashikuar ne listen e rrugeve dhe siperfaqet e tyre per sherbimin e fshirjes (bashkengjitur specifikimeve) dhe sipas hartes bashkengjitur.

##### **4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia**

Sherbimi i fshirjes se rrugeve dhe trotuareve me krahe konsiston ne:

- a. Fshirjen me punetore me fshese te gjithë rrugeve kryesore, shesheve dhe rrugeve dytesore, duke mbuluar siperfaqen e plote te trotuarit si dhe siperfaqen e plote rruge + trotuar.
- b. Ne rruget ku eshte e pamundur te kaloje fshesa ansore e makines teknologjike, (si psh. poshte makinave apo kur ka pengesa te tjera) Operatori i sherbimit duhet te pastroje me punetore.
- c. Fshirjen dhe pastrimin me punetore pastrimi te gjitha segmenteve te zena nga parkimi , trotuareve, dhe rrugeve dytesore net e cilat eshte e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.
- d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punetoret e pastrimit (fshirjes) pastrojne cdo lloj mbeturine qe ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, ne menyre qe rruget te jene plotesisht te pastërta. Edhe ky sherbim manual pastrimi perfshihet ne procesin e fshirjes si dhe ne cmimin per njesi te saj.
- e. Operatori i sherbimit duhet te zbrazë, pastroje vendin perreth dhe te mbaje paster cdo dite te gjitha koshat rrugore brenda zones se kontratuar. Sherbimi i zbrazjes dhe pastrimit te ambjentit rreth tyre behet gjate nates.

##### **4.3 Plani i punes dhe grafiket e punimeve**

- a. Fshirja e rrugeve do te behet gjate nates nga ora 24.00 deri 06.00. Mirembajtja e rrugeve do te behet nga ora 06.00 deri 22.00.
- b. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te pastrimit te zones, pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti, vetem per shkak te pamundesise se kryerjes apo ne rastet e ndryshimit te parkimit te makinave per rruge te vecanta dhe dite te vecanta dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues.
- c. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte:
  1. Oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar
  2. Numri i punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.

- d. Grafiket e punimeve do te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- e. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoha dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

#### **4.4 Rregulla per t'u zbatuar**

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster cdo siperfaqe rruge dhe trotuari ne perputhje me Rregulloren Nr. 1 dt. 05.02.2008 "Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit te qytetit" te miratuar me VKB Nr 7 Date 12.02.2008, dhe kushtet e vendosura ne kontrate.
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen rruge te papastruara apo mbeturina te palarguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk mund te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimit te nenit "Penalitete dhe gjoha".
- c. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje "Zyre te Kontaktimit" per marrjen e ankesave e cila duhet te jete e hapur ne te gjitha ditet e javes nga ora 7.00-20.00. Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene prezent gjate gjith kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe Autoritetit kontratues dhe per t'u dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.
- d. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e punetoreve dhe pajisjeve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenderit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
- e. Per raste te vecanta operatori i sherbimit eshte i detyruar te fshije rruget me shume se nje here pa shpenzime.
- f. Gjate procesit te fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave ne pusetat e elektrikut, telefonise, te ujesjellesit, ujrave te zeza, ne zgarat e pusetave te ujrave atmosferike, ne shtreterit e ujrave rrjedhese, zonat e gjelberta etj. Ne rast te konstatimit te kesaj dukurie operatori i sherbimit detyrohet t'i pastroje menjehere. Ne rast te perseritjes apo mospastrim te tyre brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit, pervec pergjegjesise se mbartjes se shpenzimeve perballat me penalitete sipas kontrates dhe ligjeve e vendimeve ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.
- g. Perdorimi i uniformave per punetoret eshte rigorozisht i detyrueshem dhe do te merren sanksione per mosplotesim te tyre.

#### **4.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrave kontraktuale te fshirjes me krahe te rrugeve dhe trotuareve si dhe te gjitha sherbimeve plotesuese te percaktuara me lart, keto mjete dhe pajisje:

- a. Cdo punetor duhet te jete i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, karroca dore, lopata, kaci, etj per te mundesuar kryerjen me cilesi te sherbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punes te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire. Punetoret e fshirjes duhet te jene te pajisur me fshese, kruajtese, lopata, kazane dore levizese dhe karroca dore.

### **5. FSHIRJA E RRUGEVE ME FSHESE MEKANIKE**

#### **5.1. Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget dhe siperfaqet per gjithe zonen e kontrates. Operatori i sherbimit do te fshije me makineri teknologjike fshese per te gjitha rruget dhe sheshet e percaktuara ne zonen qe do te kontraktohet ne nje siperfaqe 127 752 m2 ne dite. Keto jane parashikuar ne listen e rrugeve dhe volumet e tyre per sherbimin e fshirjes (bashkengjitur specifikimeve) dhe sipas hartes bashkengjitur.

## **5.2.Specifikime teknike dhe metodologjia**

Sherbimi i fshirjes se rrugeve me makineri konsiston ne:

- a. Fshirjen me makine teknologjike fshese te te gjitha rrugeve kryesore, shesheve dhe rrugeve te tjera qe jane parashikuar ne listen e rrugeve bashkengjitur. Me pas cdo mbeturine e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punetoret e sherbimit te fshirjes me krahe.
- b. Fshirja me mjete teknologjike do te behet ne te gjitha siperfaqen e caktuar, ne te kundert do te konsiderohet i pavlefshem sherbimi i kryer.
- c. Trotuarët të pastrohen e të fshihen me makina teknologjike.

## **5.3.Plani i punes dhe grafiket**

- a. Fshirja e rrugeve do te behet gjate nates nga ora 24.00 deri 06.00.
- b. Fshirja me makineri teknologjike do te kryhet sipas grafikeve te miratuar nga Autoriteti kontratues me qellim qe ne oren 7.00 zona e kontrates te jete krejtesisht e paster.
- c. Grafiket e punimeve per realizimin e ketij sherbimi pergatiten nga operatori i sherbimit dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here qe lind nevoja edhe brenda nje viti, vetem per shkak te pamundesise te kryerjes apo ne rastet e ndryshimit te parkimit te makinave per rruge te vecanta dhe dite te vecanta dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues keto ndryshime.
- d. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte
  1. Oraret e operimit ne secilen rruge
  2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin.
- e. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

## **5.4.Rregulla per t'u zbatuar**

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster cdo siperfaqe ne perputhje me rregulloren nr.1, date 05.02.2008 "Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit te qytetit" dhe ne kushtet e kontrates.
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen rruge te papastruara apo mbeturina te palarguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimit ne nenin "Penalitetet dhe gjoba".
- c. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje "Zyre te Kontaktimit" per marrjen e ankesave e cila duhet te jete e hapur ne te gjitha ditet e javes nga ora 7.00 deri 20.00. Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene prezent gjate gjith kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve

dhe te Autoritetit kontratues dhe per t'u dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.

- d. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune minimalisht numrin e kerkuar te makinerive, shofereve dhe pajisjeve per fshirjen e rrugeve.
- e. Per raste te vecanta operatori i sherbimit eshte i detyruar te fshije rruge me shume se nje here pa shpenzime.
- f. Ndalohet ne menyre kategorike ngritja e pluhurit gjate proceseve te fshirjes se rrugeve per shkak te ndotjes qe shkaktojne.

## **5.5. Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrave kontratuale te fshirjes me makineri te rrugeve si dhe te gjitha sherbimeve plotesuese te percaktuara me lart, keto mjete dhe pajisje:

- a. 2 makina teknologjike per fshirjen e rrugëve (fshese mekanike), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës, dhe me dokumentacion te rregullt per qarkullim.
- b. Te gjitha makinerite teknologjike qe do te perdoren per sherbimin e fshirjes duhet te jene ne perputhje me te dhenat teknike dhe specifike te mjeteve sipas ofertes dhe ne perputhje me kete kontrate si dhe te jene konform normave teknike te Komunitetit European.

Rregulla te tjera per mjetet dhe pajisjet :

- a. Te gjitha automjetet te cilat do te perdoren nga operatori i sherbimit per plotesimin e detyrimeve kontraktuale, mund te kontrollohen ne cdo kohe, por jo me pak se nje here ne gjashte muaj nga Autoriteti kontrator per gjendjen e gatishmerise dhe inventarizimin e tyre.
- b. Cdo makineri per fshirjen e rrugeve duhet te lahet dhe te pastrohet ne fillim ose ne fund te itinerarit ditor dhe duhet te jete e pajisur me nje sistem pompimi uji i cili sherben per mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Emri dhe telefoni publik i operatorit te sherbimit, target dhe shkrimi “Per nje Korce me te paster” duhet te jene te dukshme ne automjetet e fshirjes se rrugeve ku shkronjat duhet te jene te pakten 10 cm.
- d. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punes te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire si dhe te jene te lyera me te njejten ngjyre. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kesaj kontrate.
- e. Nje liste e makinave fshirese do t'i paraqitet Autoritetit kontratues para fillimit te veprimtarise se fshirjes.

## **6. MIREMBAJTJA E RRUGEVE DITEN**

### **6.1 Volumi i punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht te gjitha siperfaqet e tyre per zonen e kontrates.

Operatori i sherbimit do te pastroje te gjitha siperfaqet e percaktuara ne zonen e kontrates, per nje siperfaqe prej 288 547 m2 ne dite nga ora 06.00 deri 22.00.

Keto jane parashikuar ne listen e rrugeve dhe volumet e tyre per sherbimin e mirembajtjes dhe pastrimit gjate dites (bashkengjitur specifikimeve) dhe sipas hartes se bashkengjitur.

## 6.2.Specifikime teknike dhe metodologjia

Sherbimi i mirembajtjes konsiston ne :

Mirembajtjen dhe pastrimin me punetore gjate dites se siperfaqeve te siperpermendura duke mbledhur dhe larguar mbetjet e vogla dhe te medha te hedhura ne siperfaqet si rezultat i aktivitetit tregetar dhe te kembesoreve, mbajtjen paster gjate dites te koshave rrugore dhe vendit rreth tyre, etj.

## 6.3.Plani i punes dhe grafiket e punimeve

- a. Pastrimi i ketyre akseve do te behet nga ora 06.00 deri 22.00.
- b. Pastrimi i ketyre siperfaqeve do te kryhet sipas grafikeve te miratuar nga Autoriteti kontratues me qellim qe gjate gjithes dites keto siperfaqe te jene krejtesisht te paster .
- c. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit perгатiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here qe lind nevoja edhe brenda vitit dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues.
- d. Ne orarin e punimeve duhet te percaktohen sakte :
  1. Oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar
  2. Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo segment rrugor.
- e. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo ku grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendure, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

## 6.4.Rregulla per t'u zbatuar

- a. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster te gjithes siperfaqen e planifikuar ne perputhje me rregulloren nr. 1 date 05.02.2008 "Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimit te qytetit" dhe ne kushtet e kontrates.
- b. Per asnje rast nuk do te lejohen rruge dhe trotuare te papastruara apo mbeturina te pa larguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk mund te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert pergjegjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimeve te nenit "Penalitete dhe gjoba".
- c. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje "Zyre te Kontaktimit" per marrjen e ankesave e cila duhet te jete e hapur ne te gjithes ditet e javes nga ora 7.00 deri 20.00. Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene prezent gjate gjithes kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe te Autoritetit kontratues dhe per t'u dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.
- d. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e punetoreve dhe pajisjeve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenderit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
- e. Per raste te vecanta operatori i sherbimit eshte i detyruar te fshije rruget me shume se nje here pa shpenzime.
- f. Gjate procesit te fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave ne pusetat e elektrikut, telefonise, te ujesjellesit, ujrave te zeza, ne zgarat e pusetave te ujrave atmosferike, ne shtreterit e ujrave rrjedhese, zonat e gjelberta, etj. Ne rast te konstatimit te kesaj dukurie operatori i sherbimit

detyrohet t'i pastroje menjehere. Ne rast te perseritjes apo mospastrim te tyre brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit, pervec pergjegjesise se mbartjes se shpenzimeve perballet me penalitete sipas kontrates dhe ligjeve e vendimeve ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.

- g. Ndalohet ne menyre kategorike ngritja e pluhurit gjate proceseve te fshirjes per shkak te ndotjes qe shkaktojne.
- h. Perdorimi i uniformave per punetoret eshte rigorozisht i detyrueshem dhe do te merren sanksione per mosplotesim te tyre.

## **6.5.Mjetet dhe pajisjet**

Cdo punetor duhet te jete i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj. per te mundesuar kryerjen me cilesi te sherbimit.

## **7. LARJA SPECIALE E RRUGEVE**

### **7.1.Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget dhe siperfaqet e tyre ne te cilat do te kryhet sherbimi i larjes speciale te rrugeve per te gjithë zonen e kontratuar sipas listes se rrugeve dhe volumet e tyre per sherbimin e larjes speciale periodike.

Operatori i sherbimit do te kryeje larjen speciale me presion te rrugeve si sherbim 214 dite ne vit per rruget ne nje siperfaqe prej 57 788 m<sup>2</sup> sipas metodologjise se percaktuar ne zonen qe do te kontraktohet. Periudha e larjes speciale te rrugeve do te jete 01 prill deri 31 tetor.

### **7.2.Specifikime teknike dhe metodologjia**

Sherbimi i larjes speciale te rrugeve me makineri teknologjike dhe punetore ndihmes, konsiston ne:

Larjen e gjithë siperfaqes se rruges duke perdorur tubin anesor per nxjerrjen e ujit me presion te bollshem me nje norme harxhimi te ujit gjate larjes mesatarisht 2litra/m<sup>2</sup> rruge dhe puntore qe pastrojne me fshesa dhe furce duke shoqeruar sherbimin e larjes speciale. Qellimi i ketij sherbimi special eshte pastrami total i baltes apo pluhurit qe mund te mbetet pergjate siperfaqes se rruges pas kryerjes se sherbimit te fshirjes me makineri, pra eliminimi total i ndotjes nga pluhuri dhe balta.

### **7.3.Plani i punes dhe grafiku i punimeve**

1. Larja speciale e rrugeve do te behet cdo nate gjate periudhes te mesiperme, gjithmone pas sherbimit te pastrimit (fshirjes) te rrugeve nga ora 24.00 deri 06.00.
2. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te larjes speciale te rrugeve pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit sa here qe lind e nevojshme edhe brenda nje viti, vetem pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues keto ndryshime.
3. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohet sakte
  - a. Oraret e operimit ne secilen rruge.
  - b.Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin.
  - c. Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
4. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

5. Operatori i sherbimit duhet te rakordoje sipas grafikut te punimeve duke perfunduar me pare procesin e plote te fshirjes per rruget mbi te cilat do te kryhet larja speciale dhe duke kryer pas perfundimit te ketij sherbimi.
6. Operatori i sherbimit do te kryeje larjen speciale te rrugeve sipas listes se rrugeve dhe volumeve te percaktuara si dhe hartes treguese bashkengjitur kesaj kontrate.
7. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

#### **7.4.Rregulla per t'u zbatuar**

1. Autoriteti kontratues do te inspektoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
2. Ne te gjitha rastet kur nuk eshte e nevojshme kryerja e sherbimit te larjes speciale per shkak te kushteve atmosferike si shi apo debore, operatori i sherbimit nuk do te kryeje kete sherbim dhe si rrjedhim nuk do te paguhet.
3. Perfaqesuesit e Autoritetit kontraktor do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet perkatese qe per shkak te rreshjeve nuk eshte kryer sherbimi i larjes speciale.
4. Do te konsiderohet i pavlefshem kryerja e ketij sherbimi ne kushtet e rreshjeve atmosferike te pershkruara me siper. Do te behet perjashtim vetem per rastet kur kryerja e ketij sherbimi kerkohe nga Autoriteti kontratues per shkaqe te ndryshme.
5. Te gjitha shpenzimet per ujin qe do te perdoret per larjen speciale do te mbarten nga operatori i sherbimit.
6. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune minimalisht numrin e kerkuar te makinerive dhe pajisjeve per larjen speciale te rrugeve.

#### **7.5.Mjetet dhe pajisjet per larjen speciale te rrugeve**

Operatori i sherbimit duhet te siguroje per realizimin e larjes me presion te rrugeve sipas percaktimeve te kontrates, te gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet perkatese.

1. Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion dhe te perdore per plotesimin e detyrave kontraktuale te sherbimit te larjes speciale te rrugeve keto mjete:
  - Makina per larjen e rrugeve (autobote) te pajisura me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit me presion ne pjesen ansore te tij me kapacitet mbajtes jo me pak se 7000 litra uje, jo me pak se 1 cope. Te jete konform te normave teknike te Komunitetit European.
2. Automjetet qe do te perdoren per larjen speciale te rrugeve, mund te kontrollohen ne cdo kohe, por jo me pak se nje here ne gjashte muaj nga Autoriteti kontrator per gjendjen e gatishmerise dhe inventarizimin e tyre. Cdo makineri per larjen e rrugeve duhet te pastrohet dhe lahet, ne fillim ose ne fund te itinerarit ditor.
3. Te gjitha makinat per larjen speciale te rrugeve duhet te jene te rregjistruara nga Autoriteti kontrator, te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire, si dhe te jene te lyera me te njejten ngjyre.
4. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.
5. Emri dhe telefoni publik i operatorit te sherbimit, target dhe shkrimi "Per nje Korce me te paster" duhet te jene te dukshme ne automjetet e fshirjes se rrugeve ku shkronjat duhet te jene te pakten 10 cm.

### **8. LAGIA E RRUGEVE**

#### **8.1.Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget dhe siperfaqet e tyre ne te cilat do te kryhet sherbimi i lagies te rrugeve per te gjithë zonen e kontrates sipas listes se rrugeve dhe volumet e tyre per sherbimin e lagies se rrugeve.

Operatori i sherbimit do te kryeje lagien e rrugeve si sherbim 214 dite ne vit per rruget ne nje siperfaqe prej 262 267 m2 per dy lagie sipas metodologjise se percaktuar ne zonen e kontrates.

Periudha e lagies te rrugeve do te jete 01 prill deri 31 tetor.

## **8.2.Specifikime teknike dhe metodologjia**

Sherbimi i lagies se rrugeve me makineri teknologjike, konsiston ne:

Lagien e gjithë siperfaqes se rruges me makineri teknologjike. Qellimi i ketij sherbimi special eshte pastrimi i pluhurit qe mund te mbetet pergjate siperfaqes se rruges pas kryerjes se sherbimit te fshirjes me makineri, pra eliminimi i ndotjes nga pluhuri.

## **8.3.Plani i punes dhe grafiku i punimeve**

1. Lagia e pare e rrugeve do te behet cdo dite gjate periudhes se mesiperme gjithmone pas sherbimit te pastrimit (fshirjes) te rrugeve nga ora 06.00 deri 07.00. Lagia e dyte e rrugeve do te behet cdo dite gjate periudhes se mesiperme nga ora 17.00 deri 18.00.
2. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te lagies se rrugeve pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit sa here qe lind e nevojshme edhe brenda nje viti, vetem pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues keto ndryshime.
3. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohet sakte
  - a. Oraret e operimit ne secilen rruge.
  - b.Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimin.
  - c. Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
4. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
5. Operatori i sherbimit duhet te rakordoje sipas grafikut te punimeve duke perfunduar me pare procesin e plote te fshirjes per rruget mbi te cilat do te kryhet lagia e rrugeve dhe duke kryer pas perfundimit te ketij sherbimi.
6. Operatori i sherbimit do te kryeje lagien e rrugeve sipas listes se rrugeve dhe volumeve te percaktuara si dhe hartes treguese bashkengjitur kesaj kontrate.

Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

## **8.4.Rregulla per t'u zbatuar**

1. Autoriteti kontratues do te inspektoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
2. Ne te gjitha rastet kur nuk eshte e nevojshme kryerja e sherbimit te lagies se rrugeve per shkak te kushteve atmosferike si shi apo debore, operatori i sherbimit nuk do te kryeje kete sherbim dhe si rrjedhim nuk do te paguhet.
3. Perfaqesuesit e Autoritetit kontraktor do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet perkatese qe per shkak te rreshjeve nuk eshte kryer sherbimi i lagies

se rrugëve.

4. Do të konsiderohet i pavlefshëm kryerja e këtij shërbimi në kushtet e rreshjeve atmosferike të përkruara me sipër. Do të bëhet përfundim vetëm për rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti kontratues për shkak të ndryshme.
5. Të gjitha shpenzimet për ujë që do të përdoret për lagjen e rrugëve do të mbarten nga operatori i shërbimit.
6. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për lagjen e rrugëve.

## **8.5. Mjetet dhe pajisjet për lagjen e rrugëve**

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e lagjes së rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të verë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të shërbimit të lagjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për lagjen e rrugëve (autobote) të pajisura me pompe për lagje të rrugëve, 2 çape me kapacitet mbajtës jo më pak se 8000 litra ujë. Të jete konform të normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Automjetet që do të përdoren për lagjen e rrugëve mund të inspektohen në çdo kohë por jo më pak se njëherë në gjashtë muaj nga Autoriteti Kontraktor. Çdo makineri për lagjen e rrugëve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditë.
3. Të gjitha makinat për lagjen e rrugëve duhet të jenë të regjistruara nga Autoriteti kontraktor, të mbahen në gjendje të pastër dhe të mira, si dhe të jenë të lyera me të njëjten ngjyrë.
4. Një sasi e konsiderueshme e pjeseve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.
5. Emri dhe telefoni publik i operatorit të shërbimit, targat dhe shkrimi "Për një Korce me të pastër" duhet të jenë të dukshme në automjetet e fshirjes së rrugëve ku shkronjat duhet të jenë të pakten 10 cm.

## **9. PASTRIM RRUGESH DHE TROTUARESH NGA DEBORA DHE KRIPJA E TYRE**

### **9.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre në të cilat do të kryhet shërbimi i pastrimit të rrugëve nga debora dhe kripja e tyre.

Operatori i shërbimit do të kryejë këto shërbime për 20 ditë në vit në një sipërfaqe 402 068 m<sup>2</sup> sipas metodologjisë së përcaktuar në zonën kontratës, në përputhje me listën e rrugëve dhe hartën treguese bashkëngjitur.

### **9.2 Plani i punës dhe grafiku i punimeve**

1. Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve nga debora dhe kripja e tyre do të bëhet gjatë periudhës së dimrit në kohën kur këto rrugë dhe trotuare janë të bllokuara nga rreshjet e shumta të deborës dhe pengojnë qarkullimin normal të mjeteve dhe kembësoreve.
2. Orari i këtij shërbimi është i përcaktuar për vetë faktin se do të kryhet kur të jete e nevojshme nderhyrja në këto shërbime.
3. Operatori i shërbimit do të kryejë këto shërbime sipas listës së rrugëve dhe trotuareve, volumeve të përcaktuara si dhe hartës treguese bashkëngjitur.
4. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e këtij shërbimi dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërmirësimin e tyre.

### **9.3 Rregulla per t'u zbatuar**

1. Autoriteti kontratues do te inspektoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
2. Perfaqesues te Autoritetit kontratues do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet qe do te kryhet ky sherbim per efekt te pageses se operatorit te sherbimit.
3. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune minimalisht numrin e kerkuar te makinerive dhe pajisjeve per kete sherbim.

### **9.4 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i sherbimit duhet te siguroje per realizimin e pastrimit te rrugeve dhe trotuareve nga Debora si dhe kripjen e tyre keto mjete:

1. 2 (dy) borepastruese te medha, me ruspë jo më pak se 2,5 m dhe 1 (nje) e vogel, me ruspe jo më shume se 1,5 m, te jene e pajisur me mekanizmin e hedhjes se kripes.
2. Automjetet qe do perdoren per kete sherbim do te inspektohen jo me pak se njehere ne vit nga Autoriteti kontratues.
3. Te gjitha makinerite per kete sherbim duhet te jene te rregjistruara nga autoriteti kontratues, te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire.
4. Nje sasi e konsiderueshme kripe dhe pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.

## **10. DEPOZITIMI I INERTEVE DHE MIRËMBAJTJA E FUSHES SE VJETER TE DEPOZITIMIT.**

### **10.1 Volumet e punimeve**

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sasine e mbetjeve urbane qe do te perpunohen ne fushen e perpunimit te mbeturinave. Sasia qe do te perpunohet eshte 3 m<sup>3</sup> ne dite. Operatori i sherbimit do te kryeje kete sherbim per 365 dite ne vit sipas metodologjise se percaktuar dhe sherbimin e rojes 24 ore.

### **10.2 Specifikime teknologjike dhe metodologjia**

Sherbimi i perpunimit te mbetjeve urbane ne fushen e depozitimit te mbeturinave konsiston ne :

1. Shtytja e mbeturinave dhe mbulimi me dhe i tyre

### **10.3 Plani i punes dhe grafiku i punimeve**

- a. Perpunimi i mbeturinave ne fushen e depozitimit do te behet cdo dite pas terheqjes se mbeturinave nga venddepozitimet e tyre ne pikat e grumbullimit te mbetjeve urbane.
- b. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te perpunimit te mbeturinave pergatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontratues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit sa here qe lind e nevojshme edhe brenda nje viti, vetem pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor keto ndryshime.
- c. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohet sakte
  - a. Oraret e operimit per kete lloj sherbimi.

- b.Llojin dhe itinerarin e makinerive qe do te kryejne sherbimin.
- c.Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
- d. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- e. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e ketij sherbimi dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

#### **10.4 Rregulla per t'u zbatuar**

1. Autoriteti kontratues do te inspektoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
2. Perfaqesues te Autoritetit kontratues do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet qe do te kryhet ky sherbim per efekt te pageses se operatorit te sherbimit.
3. Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune minimalisht numrin e kerkuar te makinerive dhe pajisjeve per kete sherbim.

#### **10.5 Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i sherbimit duhet te siguroje per realizimin e ketij sherbimi sipas percaktimeve te kontrates te gjitha punimet materialet pajisjet, etj.

1. Fadrome me goma per ngjeshjen dhe mbulimin e mbeturinave ne fushe cope 1 (nje).
2. Ky automjet mund te inspektohet ne cdo kohe por jo me pak se nje here ne gjashte muaj nga Autoriteti Kontraktor.
3. Kjo makineri duhet te jete e rregjistruar nga Autoriteti kontraktor , te mbahet ne gjendje te paster dhe te mire
4. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.

#### **11. RICIKLIMI**

Riciklimi i materialeve (leter, plastike, metal, alumin, qelq) si detyrim i ligjit dhe si perfitim i uljes se sasise qe cohet ne landfill do te kryet ne dy forma. Per lagjet me shtepi private firma do te ndaje qeset ku familjaret do te vendosin materialet e mesiperme, ndersa per lagjet me pallate do te vensosen 100 kazane plastike me kapacitet 1,1 m<sup>3</sup>, qe do te jene te dallueshem per riciklim. Ato do te terhiqen me makina te vecanta cdo dite, ndersa qeset ne shtepi private nje here ne jave sipas grafikeve te miratuara.

#### **12.EDUKIMI PUBLIK**

Me termin "Edukim Publik" do te nenkuptohet aktiviteti publicitar i operatorit te sherbimit per te rritur dhe permiresuar njohurite e konsumatorit persa i perket mbledhjes, perpunimit dhe largimit te mbeturinave, fshirjes dhe larjes se rrugeve gjate periudhes se kontrates.

Operatori i sherbimit duhet te krijojte nje kontakt te vazhdueshem me komunitetin e zones i cili luan nje rol te rendesishem jo vetem ne mbarevajtjen e punes se operatorit te sherbimit por edhe ne minimizimin e ndotjes se ambjentit. Ky kontakt mund te realizohet si nepermjet masmediaeve ashtu dhe nepermjet shperndarjes se materialeve informuese.

Materialet informative duhet te jene ne formen e fletpalosjeve si dhe broshurave duke perfshire ne to informacione mbi ndotjen e ambjentit jo vetem ne Shqiperi por edhe ne shtetet perreth, shkaqet dhe

shkaktaret e kesaj ndotjeje si dhe masat qe do te merren per minimizimin e kesaj te fundit. Materialet sensibilizuese duhet te jene te tilla qe te ftojne qytetaret per t'u bere pjese aktive e nje shoqerie te emancipuar dhe me nje educate ambjentaliste.

Kontraktuesi duhet te paraqese per miratim, sa here te kerkohet nga autoriteti kontraktor, programin e Edukimit Publik Ambjental.

Programi i Edukimit Ambjental qe do te beje kontraktuesi duhet te miratohet nga Bashkia. Ne rast te mos permbushjes te edukimit ambjental apo plotesimit te pjeshem te tij aplikohen gjoba sipas percaktimit te bere ne nenin "Gjoba dhe penalitete".

### **13.NDALESAT, PENALITETE DHE GJOBAT**

13.1 Kontraktuesi do ta zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor Bashkinë e Korcës për çdo dëmtim të shkaktuar për shkak të tij.

13.2 Kontraktuesi i nënshtrohet ndalesave dhe penaliteteve për punë të pakryer dhe te kryer pa cilesine e kerkuar ne specifikimet teknike, ne perputhje me vleresimin e kryer nga supervizori i sherbimit:

Vleresimi i kryerjes se sherbimit do te behet si me poshte:

Nota 1 - Ndalesa nga situacioni do te jete ne masen 100%.

Nota 2 - Ndalesa nga situacioni do te jete ne masen 50%

Nota 3 - Ndalesa nga situacioni do te jete ne masen 25%

Nota 4 - Pagesa do te jete e plote

- a. Ne rastet e vleresimit me notat 1, 2, dhe 3 pervec ndaleses nga situacioni kontraktuesi eshte i detyruar te kryeje me shpenzimet e veta, ne perputhje me cilesine e kerkuar ne specifikimet teknike, te gjitha zerat e punes te vleresuar me keto nota.
- b. Në rast se Kontraktuesi nuk zbaton grafikun e pastrimit sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike, përveç ndalesës nga situacioni për sipërfaqen e papastruar, Autoriteti Kontraktor aplikon edhe gjobë deri në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë për çdo rast të konstatuar, në varësi të natyrës dhe përmasës së shkeljes. Vlera e gjobës do të mbahet nga situacioni pasardhës i paraqitur për likuidim.
- c. Ne rast se kontraktuesi nuk i sjell kontenieret e kerkuar sipas specifikimeve teknike, para lidhjes te kontrates autoriteti kontraktor nuk do te procedoje me lidhjen e kontrates.
- d. Në rast të mos riparimit të plotë të kontenierëve (në mënyrë që ai të kryejë funksionin) apo brenda afatit të përcaktuar më sipër nga Kontraktuesi, këtij të fundit do ti vendoset gjobë në masën 50.000 lekë, vlerë e cila do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.
- e. Në rastet kur konstatohet mungesa ose dëmtimi i kontenierëve në pikat e përcaktuara nga specifikimet të ndodhura për çdo rast dhe/ose çdo shkak, Kontraktuesi është i detyruar të bëjë riparimin e tyre në rast të kundërt është i detyruar të paguajë kundravleftën e kontenjerit të

dëmtuar. Në Rast se Kontraktuesi nuk pranon të shlyej vlerën e dëmit ose të kontenjerit atëherë kjo vlerë do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.

- f. Kontraktuesi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij me uniforma në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë Kontraktuese. Në rast të mos respektimit të detyrimit të mësipërm Supervisorët e Autoritetit Kontraktor bëjnë njoftim Kontraktuesit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Kontraktuesi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë Supervisorët i aplikojnë Kontraktuesit gjobë në masën nga 50.000 lekë deri 200.000 lekë, masa e gjobës së aplikuar do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.
- g. Në rastet se Kontraktuesi nuk përmbush detyrimin e kryerjes së Edukimit Publik Ambiental në përputhje me përcaktimet e bëra në piken 11 të specifikimeve teknike, supervisorët e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Korçë aplikojnë gjobë në masë 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë

### **PERMBLEDHJE E SPECIFIKIME TEKNIKE PER MAKINAT DHE MJETET E PASTRIMIT**

Makinat dhe mjetet që do të përdoren për pastrimin e qytetit të kënaqësive këto specifika:

1. 2 (dy) makina teknologjike për fshirjen e rrugëve (fshese mekanike), të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës, dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
2. 2 (dy) Borepastruese të mëdha, me ruspë jo më pak se 2,5 m dhe 1 (një) e vogël, me ruspe jo më shumë se 1,5 m, të jenë të pajisura me mekanizmin e hedhjes së kripes, dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
3. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor për mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, **cope 6 (gjashtë)** dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
4. Makina kompatator për heqjen e mbeturinave në lagjet pa kontenier, me kapacitet mbartës **jo më shumë se 4 ton, cope 2 (dy)** dhe të pajisura me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
5. Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor për mbledhjen dhe evadimin e mbeturinave, me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton, **cope 3 (tre)** dhe me dokumentacion të rregullt për transportin e mbeturinave të fshatit.
6. Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisur me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7.000 litra ujë, jo më pak se **1 (një) copë;** dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
7. Makina për lagjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për lagjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës jo më pak se 8.000 litra ujë **2 (dy) copë;** dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
8. Fadrome me goma për heqjen e inerteve dhe ngjeshjen në fushën e vjetër të depozitimit me kapacitet të koves jo më pak se 1 m<sup>3</sup>, cope 1 (një) dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.
9. Në qytet të vendosen 300 konteniere metalike, me kapacitet 1.7 m<sup>3</sup> dhe 100 me kapacitet 1,1 m<sup>3</sup>. Si dhe 100 kazane plastike 1,1m<sup>3</sup> për riciklim.  
200 konteniere 1.1m<sup>3</sup> do të vendosen neper fshatra sipas listave të miratuara. Kontenieret duhet të jenë në gjendje të rregullt, të lyer me të njëjten ngjyrë dhe të pajisur me rrota, për levizjen sa më të lehtë të tyre.

10. 4 makina transporti te vogla me kapacitet mbajtës jo më shumë se 1 ton per riciklim dhe menaxhim te menjehereshem.
11. Kamionçinë për evadimin e mbetjeve inerte me kapacitet mbajtes 1,5-3 ton, copë 2(dy)
12. Kamion me pedane per transportin e kazaneve qe do te lahen me kapaciteti mbajtes deri 1 ton, 1 (nje) mjet.

**Grupi i punës:**